



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63 të Ligjit nr. 03/L-073, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 20 paragrafi 2 i Ligjit Nr.06/L-01 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike si dhe Udhëzimin Administrativ MF-Nr-01/2019, për Themelimin dhe Funkcionimin e Komitetit të Auditimit në Sektorin Publik, si dhe vendimin Nr.1625/2021 i datës 09.06.2021, për formimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm të KQZ-së, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 07.07.2021, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nxjerr këtë:

### VENDIM

#### Për Emerimin e Anëtarit të Jashtëm të Komitetit të Auditimit të Brendshëm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

- I. Znj.Kadrije Berisha, Udhëheqëse e Divizionit të Buxhetit dhe Financave, ZKF në Ministrinë e Shëndetësisë, emërohet Anëtare e Jashtëme e Komitetit të Auditimit të Brendshëm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- II. Komiteti i Auditimit ushtron përgjegjësit sipas dispozitave të përcaktuara me Ligjin për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe Udhëzimin Administrativ për Themelimin dhe Funkcionimin e Komitetit të Auditimit në Sektorin Publik, dhe aktet tjera nënligjore për zbatimin e këtij ligji të nxjerra në pajtim me praktikat dhe standardet ndërkombëtare të auditimit.
- III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 07.07.2021

Kryetar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve



Ky vendim i dorëzohet:  
Anëtarëve të Komitetit të Auditimit të Brendshëm,  
Kryeshefit Ekzekutiv të SKQZ-së,  
Auditorit të Brendshëm,  
Arkivit të KQZ-së.